

VENDIM
Nr. 801, datë 28.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 571, DATË 6.10.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË 35 NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, NË KUADËR TË MARRËVESHJES SË GRANTIT TË LIDHUR, NDËRMJET AGJENCISË SË ZHVILLIMIT AUSTRIAK (ADA) DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN, PËR PROJEKTIN ‘PËRGJIGJE NDAJ TËRMETEVE NË SHQIPËRI’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 571, datë 6.10.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 2, vlera “... 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë ...” zëvendësohet me “... 121 743 141 (njëqind e njëzet e një milionë e shtatëqind e dyzet e tre mijë e njëqind e dyzet e një) lekë ...”;

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i transferohet fondi në masën 7 343 859 (shtatë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama